



## O i Dërguari i Allahut! Kemi mësuar se xhihadi është vepra më e mirë. Prandaj, a të marrim pjesë edhe ne në xhihad?" - "Jo, xhihadi më i mirë (për ju) është haxhi i pranuar", - iu përgjigj Profeti ﷺ

Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: "O i Dërguari i Allahut! Kemi mësuar se xhihadi është vepra më e mirë. Prandaj, a të marrim pjesë edhe ne në xhihad?" - "Jo, xhihadi më i mirë (për ju) është haxhi i pranuar", - iu përgjigj Profeti ﷺ.

[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) e konsideronin xhihadin në rrugë të Allahut dhe luftimin e armiqve prej veprave më të mira, prandaj Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pyeti Profetin ﷺ nëse mund të luftonin edhe ato. Kështu, Profeti ﷺ i udhëzoi ato se xhihadi më i mirë për to është haxhi i pranuar, që bëhet sipas udhëzimeve kuranore dhe profetike, i cili është i pastër nga mëkatet dhe syfaqësia.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/2759>

